

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues, si dhe gjyqtarët Atdhe Berisha dhe Fatmir Krasniqi si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Birsen Kume sekretare juridike pranë kësaj gjykatë, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarave M. G. dhe Sh. H. – K. që të dyja nga Prizreni, secila veç e veç për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën. par. 2.1 dhe 2.2 të KPK, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.74/2015 të datës 23.06.2015, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sefer Morina, të akuzuarave dhe mbrojtësve të tyre avokatëve N. Q. dhe E. G., më datë 05.04.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarat:

M. G., nga i ati Gj. dhe e ëma F., e lindur H., e lindur me datë ... në fshatin R. Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren, ku jeton, e martuar, nënë e pesë fëmijëve, ka të kryer fakultetin dhe studimet master – drejtim menaxhimi i biznesit, profesoreshë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e pajisur me letërnjoftim me numër personal

SH. H. – K., nga i ati Gj. dhe e ëma F., e lindur H., e lindur me datë ... në Prizren, ku jeton, e martuar, nënë e tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin filologjik, profesoreshë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e pajisur me letërnjoftim me numër personal

LIROHEN NGA AKUZA

I.

E akuzuara M. G.

Se në periudhën kohore prej muajit Shtator deri në Dhjetor të vitit 2014 në Prizren, duke shfrytëzuar pozitën zyrtare dhe autorizimet e saj në cilësinë e drejtoreshës së shkollës së mesme ekonomike “ Y. P. “ në Prizren, nuk i ka përmbushur dhe kryen me dashje detyrat e domosdoshme të përcaktuara me ligj dhe me këtë i mundëson përfitim material personit tjetër dhe duke shkaktuar dëm personit tjetër, në atë mënyrë që nuk e kontrollon dhe lejon që e pandehura Sh. K. në cilësinë e profesoreshës (të cilën e ka motër) të mos i mbaj orët e mësimi në lëndën “ Gjuhë dhe Komunikim“ duke i mundësuar që për orët e humbura të kompensohet me pagë të plotë në të ardhura personale, për katër muaj, të cilat orë i ka vërtetuar si të mbajtura, me ç’ rast i shkakton dëm buxhetit të Arsimit të Kosovës në shumën rreth 700 euro.

-këso dore do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën. par. 2.1 dhe 2.2 të KPK .

- Pasi që nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, e në mbështetje të nenit 364 par.1 nën. par.1.3 të KPP-së

II.

E akuzuara Sh. H. – K.

Se gjatë periudhës të vitit shkollor prej muajit Shtator deri në muajin Dhjetor të vitit 2014, duke shfrytëzuar pozitën zyrtare dhe autorizimet e saj të profesoreshës në shkollën e mesme ekonomike “ Y. P. “, me qëllim që të përfitojë dobi materiale për vete dhe ti shkaktojë dëme tjetrit, me dashje nuk i kryen dhe përmbush detyrat e saja të domosdoshme të përcaktuar me ligj dhe me dijeni shkel ligjin e arsimit lidhur me detyrat e punësimit, në atë mënyrë që si profesoreshë e caktuar për mbajtjen e orëve në lëndën “ Gjuhë dhe Komunikimi “, për klasat e XII-ta, nuk i mban orët e mësimit prej muajit Shtator deri në Dhjetor 2014 përkundër mos mbajtjes ka pranuar pagën e plotë në të ardhura personale, me ç’ rast i shkakton dëme në shumën prej 700 euro buxhetit të Arsimit të Kosovës.

-këso dore do të kishte kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën. par. 2.1 dhe 2.2 të KPK .

- Pasi vepra me të cilën akuzohet nuk përbënë vepër penale, e në mbështetje të nenit 364 par.1 nën. par.1.1 të KPP-së

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.74/2015 të datës 23.06.2015, kundër të akuzuarve M. G. dhe Sh. H. – K. që të dyja nga Prizreni, secila veç e veç për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën. par. 2.1 dhe 2.2 të KPK. Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ngelur në tërësi pranë aktakuzës, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se gjatë shqyrtimit kryesor nga provat e administruara veçmas dëshmitë e dëshmitarëve, provave materiale të cilat ekzistojnë të bashkangjitura aktakuzës e gjithashtu edhe dëshmia e dëshmitarit – inspektorit të arsimit, pa dyshim është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendja faktike në këtë çështje penale dhe dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarat e kanë kryer këtë vepër penale, me vet faktin se e akuzuara M. G. si drejtoreshë e shkollës së mesme “Y. P.” në Prizren me dashje dhe paramendim ka shkelur dispozitat e ligjit të arsimit para universitar dhe dispozitat e akteve normative të cilat janë të nxjerr nga i njëjti ligj pasi që e njëjta si mbikëqyrëse e personelit arsimor të kësaj shkolle, me vetëdije e ka lëshuar mbikëqyrjen e punës dhe vijimit të mësimit nga e akuzuara e dytë Sh. K. dhe të njëjtës edhe pse gjatë tërë kohës sa ka qenë e caktuar për mbajtjen e orëve të mësimit për orën përkatëse e njëjta nuk e ka mbajtur asnjë orë dhe për këtë e akuzuara e parë duke qenë në dijeni, ka lejuar konfirmimin dhe nënshkrimin e proceseve se ajo ka mbajtur procesin mësimor dhe për të njëjtën është paguar në mënyrë të plotë me çka edhe ka dëmtuar buxhetin arsimor të Kosovës, e këtë fakt po ashtu e ka vërtetuar edhe inspektori i arsimit me rastin e inspektimit të tij duke konstatuar shkeljet e ligjit nga e akuzuara e parë gjë që në kuadër të kompetencave të veta edhe ka dhënë rekomandimet e duhura të parapara me ligj. Gjithashtu nga provat e vërtetuara dhe të administruara e

akuzuara Sh. H. me vetëdije, lëndën për të cilën ka qenë e caktuar të mbajë procesin mësimor nuk e ka mbajtur edhe pse e thirrur që ti mbajë orët ashtu që pas intervenimit të inspektorit të arsimit, rubrikat në të cilat është dashur të shënohen numri dhe temat e lëndëve të cilat kanë qenë të parapara të shtjellohen ato i ka plotësuar duke firmosur formalisht gjë që këtë dukuri e kanë vërejtur dhe për të kanë reaguar edhe një pjesë e konsiderueshme e kolegëve profesorë të shkollës të cilët përveç se kanë shkruar peticion drejtuar institucionit më të lartë arsimor, policisë dhe inspeksionit të arsimit, njëherit reague të tilla ka pasur edhe nga vet nxënësit e klasave në të cilat ka qenë e caktuar për mbajtjen e orëve mësimore të lëndës përkatëse, ashtu që për shkeljet e njëjta të ligjit e akuzuara e parë me detyrim të inspeksionit të arsimit është obliguar që të ndërmer masa ligjore në kuadër të kompetencave të saja duke i shqiptuar të akuzuarës së dytë Sh. vërejtje me shkrim e gjithashtu është obliguar që tek pas semestrit të dytë pasi kanë kaluar koha dhe afati i paraparë me ligj kur është dashur të mbahen orët dhe mësimi në lëndën përkatëse, të njëjtat është i detyruar që ti mbajë rishtazi, dhe atë pa u kompensuar pasi që vet fakti flet se e njëjta me dashje dhe paramendim ka bërë shkelje të rregullave përkatësisht dispozitave të aktit administrativ shkollor i cili është i bazuar me ligjin e arsimit para universitar. Nga të gjitha këto është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë gjendja faktike në këtë çështje penale me çka edhe të akuzuarat kanë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 para.1 dhe 2 nënpar.2.1 dhe 2.2 të KPK, dhe i propozon që pas vlerësimit të provave dhe pleqërimit në këtë çështje penale të akuzuarat ti shpall fajtor për veprat penale dhe të dënohen sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarës M. G. av. N. Q. i cili fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim, të cilën e ka elaboruar duke shtuar se provat që janë administruar në këtë çështje e të cilat kryesisht janë deklaratat e dëshmitarëve, është arritur të vërtetohet një fakt që nuk është thënë në aktakuzë dhe në fjalën përfundimtare të prokurorit e që ka të bëjë me orët e pa mbajtura (të dyshuara me dyshim që nuk janë mbajtur) që në fakt mbrojtja është e bindur që këto orë janë mbajtur, me vetë faktin se po këta dëshmitarë kanë vërtetuar se lënda “ Firmë Ushtrimore “ mbahet nga dy profesorë në të njëjtën kohë. Një fakt tjetër që nuk është cekur në aktakuzë e që është vërtetuar nga provat është ajo se e akuzuara Sh. nuk ka munguar nga mësimi, gjegjësisht nga paraqitja në vend të punës dhe qëndrimi i saj në shkollë gjatë orarit. Po ashtu është vërtetuar se në rastin konkret në shkollën e lartpërmendur janë një fond i orëve prej 7 orë në javë që do të thotë gjatë gjithë javës e akuzuara Sh. dyshohet se nuk paska mbajtur nga një orë në ditë, kjo pa dyshim e vërteton edhe faktin tjetër se e mbrojtura e tij nuk ka pas mundësi ta dijë se a po shënohen në ditar njësitë mësimore-temat duke e pa që profesoresha Sh. është prezentë në shkollë, nga kjo del se është vërtetuar ky konstatim se vërtetë nuk ka pas asnjë arsye të që këto orë mos të mbahen. Po ashtu nga provat është vërtetuar edhe një fakt se ajo mungesat gjegjësisht mos mbajtjen e orëve si procedurë e dallon përmbajtja se pse një orë mund të mos mbahet edhe kur nuk mungon profesori për arsyet të ndryshme ndërsa mungesat do të thotë mosparaqitja në punë e në këtë rast drejtori i shkollës mos mbajtjen e orëve kur nuk ka mungesë të arsimtarëve nuk mund ta dijë vetëm nëse rastësisht informohet ose i raportohet e i cili raport vazhdimisht në bazë krejt fakteve të vërtetuara në këtë çështje del se bëhet në fund të tremujorit periudhë m brenda cilës ekziston dyshimi për veprën penale, prandaj edhe e akuzuara M. nuk ka mund ta dije e as që ka pas si ta dijë apo shënohen njësitë mësimore ose jo në ditar. Andaj nga arsyet e lartcekura i propozon gjykatës që në kuptim të nenit 364 të KPP të akuzuarën M. G. ta liron nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarës Sh. H. av. E. G. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e paraqitur nga ana e prokurorit të shteti pas administrimit të provave e njëjta faktikisht dhe juridikisht nuk mund të qëndrojë. Nga provat e administruar dhe pas dëgjimit këtu dy të akuzuarve dhe dëshmitarëve të cilët në mënyrë të qartë kanë vërtetuar se lënda “ Firma Ushtrimore “ e ligjërimi nga e akuzuara Sh. është mbajtur dhe atë dy herë një herë së bashku me profesorin e

lëndës për që nuk është regjistruar në rubrikën përkatëse e kjo mund të konsiderohet si një lëshim teknik administrativ dhe kjo ka ndodh në periudhën e parë në tremujorin e parë kurse prokuroria pretendon se orët janë mbajtur pas gjysmë vjetorit të dytë çka nuk qëndron kjo e dhënë sepse nga vet e akuzuara dhe nga profesorët tjerë që janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve vërtetojnë një të dhënë se në gjysmë vjetorin e dytë është filluar me orë shtesë për plotësimin e orëve të cilët nuk janë shënuar në ditar. Në rastin konkret nxënësit nuk kanë humb asgjë, pas që janë kompensuar dy herë e të cilët janë përgatitur edhe më mirë. Po ashtu nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se buxheti i Kosovës është dëmtuar, pasi që e akuzuara Sh. nuk ka marr dy paga për orët shtesë por ka marr rrogën për angazhimet e saja si profesoreshë në shkollën e mesme “Y. P.”. Po ashtu pas analizimit të elementeve të veprës penale, dashja si element qenësor i veprës penale dhe tiparet e saja pikërisht këtu mungon dashja sepse në rastin konkret nuk ka dashje por pakujdesi dhe atë pakujdesi pa vetëdije nga se orën të cilën kanë prezantuar dy profesorë gjithmonë nga profesori kryesor i lëndës në rubrikën e ditarit të punës është shënuar ora e mbajtur por vetëm nuk është shënuar nga profesoresha Sh. e cila nga pakujdesia dhe për shkak se për herë të parë është inkorporua kjo lëndë nuk e ka regjistruar temën e shtjelluar ose orën e mbajtur. Po ashtu pas vërejtjeve të bëra nga inspekcioni dhe drejtoresha e shkollës e njëjta në përpikëri iu ka përmbajtur urdhrin dhe vendimit të inspekcionit. Po ashtu edhe pretendimi tjetër i prokurorisë se për shkak të mos mbajtjes së orëve janë ankuar nxënësit, ky pretendim nuk qëndron sepse askush nuk është ankuar për një gjë të tillë. Andaj në rastin konkret mbrojtja konsideron se nxënësit nuk janë dëmtuar, nuk ekziston dashja për kryerjen e një veprë penale, nuk ekziston përfitimi pasuror, prandaj nga arsyet e lartcekura i propozon gjykatës që konform nenit 364 par.1.3 të merr aktgjykim lirues nga se nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penale që i vihet në barrë në bazë të aktakuzës.

E akuzuara M. G. duke mohuar kryerjen e veprës penale, në mbrojtjen e vet ka deklaruar se gjatë periudhës kohore prej muajit Maj të vitit 2014 deri në fund të muajit Janar të vitit 2015 ka qenë drejtoresh e shkollës ekonomike “Y. P.” e në të cilën shkollë ka punuar edhe motra e saj Sh. H. – K. si profesoreshë- mësimdhënëse e lëndës gjuhë dhe letërsi, por meqë e njëjta nuk e ka pas normën e plotë të njëjtës i janë caktuar edhe shtatë orë për mbajtjen e lëndës “Gjuhë dhe komunikim” e cila është në kuadër të lëndës “Firma ushtrimore”, ku orët e kësaj lënde i ka pas të caktuara ti mbaj prej fundit të muajit shtator deri në fund të vitit shkollor 2014/15. Këto orë kanë qenë të caktuara për klasën e XII-të dhe deri sa e ka ftuar policia dhe e ka njoftuar për rastin nuk ka qenë në dijeni se Sh. nuk i ka mbajtur orët e mësimin dhe deri atëherë e ka ditur se orët në lëndën “Gjuhë dhe komunikim” i ka mbajtur, por gjatë kontrollimit të ditarit të mësimin, pranon se ajo nuk i kishte shënuar disa orë në rubrikat përkatëse edhe pse e ka ditë se faktikisht i ka mbajtur orët e mësimin. Për orët e mbajtura e ka marrë pagën e plotë për mbajtjen e të gjitha orëve të parapara sipas normës. Po ashtu e akuzuara M. mes tjerash pranon se gjatë vitit 2014 në shkollën ku punon kanë qenë për inspektim inspektorët e arsimit e të cilët pas kontrollimit të ditarëve të mësimin për klasat e XII-ta, i kanë dhënë një procesverbal në të cilën për parregullsitë e konstatuara kanë rekomanduar që ndaj profesoreshës Sh. të ndërmer masa ligjore respektivisht ndëshkuese si dhe inspektorët e arsimit kanë rekomanduar që në afatin prej 60 ditëve orët të kompensohen e drejtorja e shkollës të përpilojë planin e mbajtjes së orëve në lëndën “Gjuhë dhe komunikim” dhe në afat prej 8 ditëve pas zbatimit të këtij rekomandimi ta njoftojë Sektorin e inspektoratit të Arsimit në Prizren. E njëjta ka shtuar se ndaj profesoreshës Sh. ka shqiptuar një masë disiplinore – vërejtje me gojë të shprehur me shkrim, e gjithashtu ka përpiluar orarin për mbajtjen e orëve brenda periudhës kohore Janar – Mars të vitit 2015, të cilat orë edhe i ka mbajtur profesoresha e për të cilat ka prezantuar dëshmi nga lista e ditarit shkollor të mësimin.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarës M. G. gjykata në tërësi ia fali besimin ngase një mbrojtje e tillë ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesorë.

E akuzuara e pohon se të akuzuarën Sh. H. K. e ka motër, të njëjtat gjatë periudhës kohore 2014/15 kanë punuar së bashku në shkollën e mesme ekonomike “ Y. P. “ në Prizren, e akuzuara M. ka qenë drejtoreshë e shkollës në të cilën detyrë ka qenë prej muajit Maj të vitit 2014 e deri në fund të muajit Janar të vitit 2015, ndërsa e akuzuara Sh. ka qenë mësimdhënëse në këtë shkollë dhe ka dhënë lëndën mësimore “ Gjuhë dhe letërsi shqipe “ dhe e njëjta nuk ka pas normën e plotë të orëve dhe për arritjen e kësaj norme i është caktuar të mban edhe lëndën mësimore “ Gjuhë dhe Komunikim “ e cila ka qenë në kuadër të lëndës mësimore “ Firma Ushtrimore “, këto orë janë caktuar të mbahen nga ana e akuzuarës Sh. për klasat e XII-ta. Gjithashtu e akuzuara e pohon se në shkollën e lartpërmendur kanë qenë inspektorët e arsimit të cilët kanë bërë kontrollimin e ditareve e të cilët kanë konstatuar parregullsi, të cilët kanë rekomanduar që ndaj këtu akuzuarës Sh. të merren masa ligjore si dhe kanë rekomanduar në afat prej 60 ditëve të mbahen këto orë mësimore, për çka e akuzuara M. në cilësi të drejtoreshës i ka zbatuar të gjitha rekomandimet e Inspeksionit ashtu që të akuzuarës Sh. i ka shqiptuar një masë disiplinore – vërejtje me gojë të shprehur me shkrim, e gjithashtu ka përpiluar orarin për mbajtjen e orëve brenda periudhës kohore Janar – Mars të vitit 2015, të cilat orë edhe i ka mbajtur profesoresha e për të cilat ka dëshmi nga lista e ditarit shkollor të mësimi. Një mbrojtje e tillë ka mbështetje në vërejtjen me gojë e shprehur me shkrim nr.37/2015 të datës 13.01.2015 e lëshuar nga SHMEL “ Y. P. “, në orarin për orët plotësuese në klasat e FU – Firma Ushtrimore, në fotokopjen e listave të ditarit të mësimi për lëndën Firma Ushtrimore, gjuhë dhe komunikim sipas ditëve të mësimi për muajin Janar, Shkurt dhe Mars 2015, në procesverbalin të mbajtur gjatë inspektimit special nr.379 të dt.13.12.2015 nga MASHT – Departamenti i Inspeksionit të Arsimit – Sektori i Inspeksionit të Arsimit në Prizren, në listën e pagave nga buxheti i R. së Kosovës për të akuzuarën Sh. H. – K., e gjithashtu një gjë e tillë është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit R. J. Inspektor pranë Inspektoratit të Arsimit.

E akuzuara Sh. H. – K. duke mohuar kryerjen e veprës penale, në mbrojtjen e vet ka deklaruar se të akuzuarën M. e ka motër, se është profesorësh e gjuhës dhe letërsisë në shkollën ekonomike “ Y. P. “, po ashtu ka shtuar se nga koordinatorja M. Q. e cila është e trajnuar për lëndët firma ushtrimore dhe ka qenë e caktuar nga ajo që ti mbajë orët e lëndës “ gjuhë dhe komunikim “ me që nuk e ka pas normën e plotë të orëve dhe këto orë i janë caktuar për klasën e XII-të dhe atë shtatë orë në javë, ka filluar ti mbaj orët prej fundit të muajit shtator 2014 e deri në fund të muajit dhjetor. Mohon që të mos i ketë mbajtur orët e mësimi, por cek se orët nuk i ka shënuar në rubrikat përkatëse në ditarin mësimor si dhe arsyen tjetër se profesoreshat tjera të cilat ligjërojnë i kanë thënë se nuk ka nevojë ti të shënon orën sepse këto orët i shënojnë profesorët të cilët e mbajnë lëndën firmën ushtrimore, ndërsa faktikisht thotë se orët i ka mbajtur. Pranon se pagën e ka marrë të plotë dhe është paguar për orët e caktuara të lëndës “ gjuhë dhe komunikim “. Po ashtu ka deklaruar se ka qenë në dijeni se për këtë çështje edhe inspektorët e arsimit dhe më vonë ka kuptuar se i kanë rekomanduar drejtoreshës që në afat prej 60 ditëve të mbahen orët e lëndës “ gjuhë dhe komunikim “ si dhe drejtoresha i ka shqiptuar një masë disiplinore – vërejtje me gojë të shprehur me shkrim edhe pse këto veprime nuk i ka kryer, dhe pranon se të vetmen gabim që e ka bërë se nuk ka shënuar orë në ditar të cilat të gjitha i ka mbajtur dhe ky ka qenë konstatim i gabuar nga inspektorët. Pranon se më vonë nga pagat të cilat i ka marrë të plota gjatë kohës kur ka qenë e caktuar ti mbajë orët e lëndës përkatëse, më vonë i është zbritur nga të ardhurat shuma për të gjitha orët e paguara se kanë qenë të caktuar deri në fund të muajit Dhjetor, po ashtu ka theksuar se të gjitha orët përsëri i ka mbajtur prej fillimit të vitit 2015, brenda tre muajve sipas orarit të cilën e ka caktuar drejtoresha.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarës Sh. H. K. gjykata konstatoi se e akuzuara Sh. e ka mohuar që të mos i ketë mbajtur orët e mësimi duke shtuar se orët i ka mbajtur por nuk i ka shënuar, e njëjta e ka pranuar se drejtoresha i ka shqiptuar një masë disiplinore – vërejtje me gojë të shprehur

me shkrim, gjithashtu ka pranuar se të gjitha orët përsëri i ka mbajtur prej fillimit të vitit 2015, brenda tre muajve sipas orarit të cilën e ka caktuar drejtoresha.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesorë i ka nxjerrë të gjitha provat, ka dëgjuar dëshmitarët B. K.– L., N. A., E. J., Y. B., H. Sh., R. J., S. Rr. si dhe ka administruar edhe provat tjera materiale: leximi i vërejtjes me gojë e shprehur me shkrim nr.37/2015 të datës 13.01.2015 e lëshuar nga SHMEL “ Y. P. “, leximi në orarin për orët plotësuese në klasat e FU – Firma Ushtrimore, leximi në fotokopjen e listave të ditarit të mësimit për lëndën Firma Ushtrimore, gjuhë dhe komunikim sipas ditëve të mësimit për muajin Janar, Shkurt dhe Mars 2015, leximi i procesverbalit të mbajtur gjatë inspektimit special nr.379 të dt.13.12.2015 nga MASHT – Departamenti i Inspeksionit të Arsimit – Sektori i Inspeksionit të Arsimit në Prizren, leximi në listën e pagave nga buxheti i R. së Kosovës për të akuzuarën Sh. H. – K. për muajt Shtator, Tetor dhe Nëntor 2014.

Dëshmitari R. J. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është inspektor i arsimit, në sektorin e SIA-së, në Prizren, e cila është në kuadër të Ministrisë së Arsimit, MASHT. Ka bërë inspektim gjatë vitin 2014 në shkollën e mesme “Y. P.” në Prizren, me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit me datë 18.12.2014. Ky inspektim është bërë për shkak të mosrealizimit të orëve të lëndës Gjuhë dhe Komunikim të klasës XII-1 deri XII-7, i cili inspektim ka qenë special, jo i rregullt, dhe pas shikimit të ditarëve të këtyre klasave është konstatuar se këto lëndë Gjuhë dhe Komunikim nuk janë mbajtur nga ana e Sh. K. e cila ka qenë e caktuar për ti mbajtur. Pas inspektimit ka marr masa, duke bërë rekomandim që brenda afatit 60 ditorë të gjitha orët e pa mbajtura të mbahen ,dhe mësimdhënës Sh. K. të i jepet vërejtja nga ana e Drejtorit të cilin rekomandim ia kemi dërguar Inspeksionit të Inspektuar, përkatësisht shkollës. Rekomandimi i parë apo orët që janë dashur të cilat janë dashur të mbahen kanë filluar të mbahen gjatë periudhës prej datës 01.09.2015 deri me datën 06.03.2015. I njëjti mes tjerash ka theksuar se orët janë mbajtur sipas rekomandimit të inspektoratit, të cilët orët janë mbajtur jashtë orarit të mësimit dhe në rastin konkret nuk është shkaktuar dëm material sepse orët e humbura janë kompensuar përkatësisht janë mbajtur dhe për këto orët që janë mbajtur jashtë orarit të punës e akuzuara Sh. nuk është paguar e cila vërtetohet edhe nga lista e pagave. I njëjti ka theksuar se nuk e ka ditë që nxënësit edhe nëse profesoresha mungon qëndrojnë në kabinet dhe nuk ka pas dijeni që e akuzuara Sh. nuk ka pasur drejtë ti noton nxënësit.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitarit R. J., gjykata dëshmisë së tillë në tërësi ia ka falur besimin ngase një dëshmi e tillë ka mbështetje edhe në provat materiale që ndërlidhen me rolin e këtij dëshmitari si inspektor i arsimit që ka kryer inspektimin në rastin konkret.

Dëshmitarja B. K. – L., gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është profesoreshë e gjuhës angleze dhe punon në shkollën e mesme ekonomike “Y. P.” dhe gjatë periudhës prej shtatorit 2014 ka qenë kujdestare e klasës 12/7. E dinë që ekziston lënda Firma Ushtrimore, ndërsa nuk e ka ditë që edhe lënda Gjuhë dhe Komunikim. Orët e lëndës firmë ushtrimore i ka konsideruar si të mbajtura sepse kanë qenë të plotësuara dhe të nënshkruara nga profesoresha e firmës ushtrimore N. A. Po ashtu gjatë kësaj periudhe ka dhënë mësim edhe profesoresha këtu e akuzuara Sh. H. K. e cila ka dhënë lëndën gjuhë dhe letërsi shqipe. Si kujdestare e klasës ka për detyrë që të kontrollojë ditarit dhe orët a janë të mbajtura. E njëjta ka shtuar se në ditar është rubrika ku shënohet orët e mbajtura edhe ato të pa mbajtura dhe vetëm aty evidentohen. Po ashtu thekson se nxënësit e klasës së XII/7 e cila ka qenë kujdestare nuk e kanë njoftuar se nuk janë duke mbajtur orët e lëndës gjuhë dhe komunikim. E njëjta thekson se si arsimtare e gjuhës angleze ka ndodh që të e zëvendësojë ndonjë kolegë. Po ashtu ka theksuar se ka ndodhur të harron që ta shënon orën të cilën e ka mbajtur.

Dëshmitarja N. D. A., gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është profesoreshë e gjuhës angleze dhe punon në shkollën e mesme ekonomike “Y. P.” dhe gjatë periudhës prej shtatorit 2014 dhe ligjëron lëndën Firmën Ushtrimore, edhe lëndët financa, në fillim të vitit shkollor ka filluar me Firmën Ushtrimore dhe Lëndën Financa. Fillimisht nuk e ka dit se ekziston lënda gjuhë dhe komunikim dhe më vonë ka kuptuar se këtë ligjëron Sh. H. K. Lëndën firmë ushtrimore i ka mbajtur të hënën, enjte dhe të premte dhe kjo lëndë mbahet për klasat e XII-ta dhe ato ka 7 orë në javë për secilën klasë. Shton se lidhur mos mbajtjen e orëve nga ana e profesoreshës Sh. H. nuk ka pas asnjë ankesë nga ana e nxënësve. Shton se lënda gjuhë dhe komunikim është kuadër të lëndës Firmë Ushtrimore dhe se drejtoresha e shkollës e ka informuar se mund të përdor ndihmën e profesoreshës Sh. për gjuhë dhe komunikim në kuadër të Firmës Ushtrimore. Shton se nxënësit nuk kanë humbur asgjë nga se i ka mbajtur 8 orë nga lënda gjuhë dhe komunikim 6 orë në shkollë dhe dy orë praktikë.

Dëshmitarja E. J. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është mësimdhënëse në shkollën e mesme ekonomike “ Y. P. “ në të cilën shkollë punon që nga vitit 1984. Gjatë vitit shkollor 2013/2014 ka qenë kujdestare e klasës XII-5. Në klasën e saj gjatë këtij viti në kuadër të lëndës Firma Ushtrimore është edhe lënda gjuhë dhe komunikim të cilët e ka mbajtur një ditë e caktuar dhe lëndën gjuhë dhe komunikim, ka ligjëruar Sh. H. Lënda firma ushtrimore mbahet në një klasë të veçantë dhe mësimet nxënësit i kanë mbajtur në orarin e pasdites. Po ashtu ka theksuar se në ditarin e klasës që ka qenë kujdestare e klasës firma ushtrimore është mbajtur të hënën pas dite profesoresha Xh. M. rubrikat që figurojnë i ka plotësuar për të hënën kur mbahet firma ushtrimore, profesoresha Sh. H. orët i ka plotësuar, ku në orët e gjuhës dhe komunikim ka par me tema dhe nënshkrim të profesoreshës Sh. H. Po ashtu për mos mbajtjes së kësaj lënde nuk ka pas vërejtje nga nxënësit po ashtu as nga kolegët lidhur me këtë çështje nuk ka dëgjuar ankesë. E njëjta ka theksuar se kontrollin e ditarit e bën zëvendës drejtori i shkollës, e sa i përket raportit të kujdestarit me drejtorin e shkollës janë se nëse ekziston ndonjë problem raportohet tek i njëjti.

Dëshmitari Y. B. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është mësimdhënëse në shkollën e mesme ekonomike “ Y. P. “.Gjatë vitit shkollor 2013/2014 ka qenë kujdestare i klasës XII-1. Në klasën e tij gjatë këtij viti është mbajtur lënda gjuhë dhe komunikim, e të cilat janë mbajtur me plotësim shtesë nga ana e Sh. H. Kjo lëndë fillimisht nuk është mbajtur, mirëpo mandej ka filluar të evidentohen ditën e enjte e krejt më vonë edhe të fshihen dhe të evidentohen në një ditë tjetër në ditën e mërkurë kur kanë pas lëndën firmë ushtrimore sepse lënda gjuhë dhe komunikim është në kuadër të firmës ushtrimore. Kjo lëndë është caktuar prej 1 shtatorit të vitit shkollor 2014/15. Nuk ka dëgjuar prej ndonjë kolegu se kjo lëndë nuk është mbajtur. Lënda firmë ushtrimore zhvillohet në kabinet e jo në klasë një profesor i mbanë 8 orë ndërsa një orë profesori tjetër gjuhë dhe komunikim. I njëjti ka theksuar se profesoresha e lëndës firmë ushtrimore nuk e din që a duhet të jetë prezent edhe në lëndën gjuhë dhe komunikim. Shton se kjo lëndë është mbajtur, ndërsa nuk është mbajtur vetëm në periudhën prej muajit shtator e deri në mesin e tetorit. Thekson se kur e mbajnë dy profesorë vetëm njërin e mban orën e mësimet. Në pyetjen e kryetarit të trupit gjykues se a ka ndodh ndonjëherë që ndonjë profesor tjetër mos ta mbajë ndonjë orë në klasën tuaj, i njëjti ka theksuar se po.

Dëshmitarja H. Sh. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar është mësimdhënëse në shkollën e mesme ekonomike “ Y. P. “.Gjatë vitit shkollor 2013/2014 ka qenë kujdestare e klasës XII-3, se lënda gjuhë dhe komunikim nga ana e Sh. H. kanë qenë të mbajtura, sepse këto orë kanë qenë të shënuara si dhe ka qenë nënshkrimi i profesoreshës. Shton se të gjitha orët kanë qenë të mbajtura, me përjashtim atyre orëve kur ka qenë e sëmurë, këto orë janë mbajtur nga ana e profesoreshës M. Ç. Shton se lënda gjuhë dhe komunikim është në kuadër të lëndës Firmë ushtrimore.

Dëshmitari S. Rr. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se është mësimdhënës në shkollën e mesme “ Y. P. “ dhe gjatë vitit shkollor 2014/15 ka qenë kujdestar klase i klasës XII/6 dhe detyrat i ka pas që të merret me çështje administrative e që janë plotësimi i dokumenteve të nxënësve, dëftesat, përcjellja e ditarit, problemet që kanë të bëjnë me nxënësit. Ka theksuar se lëndën gjuhë dhe komunikim ka qenë e caktuar ti mbajë Sh. H. Në bazë të shënimeve që janë në ditar në rubrikën ku shënohet ora e mësimit, lënda në fjalë është mbajtur por për shkak të natyrës së punë ndodh që me vonesë të shënohet ora dhe lidhur me mos mbajtjen e lëndës gjuhë dhe komunikim nuk ka pas ankesa nga ana e nxënësve por edhe nga kolegët nuk ka dëgjuar që lënda në fjalë që nuk është mbajtur.

Duke analizuar deklaratat e dëshmitarëve, gjykata ka vërtetuar se lënda “ Gjuhë dhe Komunikim “ ka qenë e integruar kuadër të lëndës “ Firmë Ushtrimore “ e të cilën e kanë mbajtur dy mësimdhënës, se lënda “ Gjuhë dhe Komunikim “ është mbajtur e cila është kompensuar e cila është mbajtur nga ana e profesoreshës Sh. H. – K. dhe askush nuk është dëmtuar e radhë të parë nxënësit sepse të njëjtit i kanë mbajtur orët në lëndën e lartcekur. Po ashtu këtë më së miri e vërteton edhe dëshmitari R. J. i cili me dëshminë e tij e forcon bindjen se të akuzuarat nuk e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, i cili mes tjerash ka theksuar se orët në lëndën “ Gjuhë dhe Komunikim, kanë filluar të mbahen gjatë periudhës prej datës 01.09.2015 deri me datën 06.03.2015, e të cilat orë janë mbajtur sipas rekomandimit të inspektoratit, dhe në rastin konkret nuk është shkaktuar dëm material sepse orët e humbura janë kompensuar dhe për këto orët që janë mbajtur jashtë orarit të punës e akuzuara Sh. nuk është paguar e cila vërtetohet edhe nga lista e pagave. Andaj gjykata dëshminë e këtij dëshmitari dhe dëshmitarëve tjerë ia fali tërësisht besimin.

Nga vërejtja me gojë e shprehur me shkrim nr.37/2015 të datës 13.01.2015 e lëshuar nga SHMEL “ Y. P. “, nga e cila vërtetohet se ndaj të punësuarës Sh. H. – K. e caktuar në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës profesionale dhe Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, e cila përkundër caktimit të detyrave të punës edhe në “ Firmat Ushtrimore “ pjesërisht nuk i ka shënuar orët në lëndën “ Gjuhë dhe Komunikim “ e cila ka qenë e integruar në lëndën “ Firmë Ushtrimore “ pasi që ka bërë lëshime gjatë orëve mësimore, i është shqiptuar vërejtja me gojë e shprehur me shkrim për shkak të mos plotësimit të orëve të mbajtura.

Nga orari për orët plotësuese në klasat e FU – Firma Ushtrimore, vërtetohet se mësimdhënësja Sh. H. – K. gjatë periudhës 12.01.2015 e deri 12.03.2015 është obliguar të mbajë orët plotësuese në klasat e XII-ta për lëndën FU (Firmë Ushtrimore).

Nga fotokopja e listave të ditarit të mësimit për lëndën Firma Ushtrimore, gjuhë dhe komunikim sipas ditëve të mësimit për muajin Janar, Shkurt dhe Mars 2015, është vërtetuar se orët në lëndën Gjuhë dhe Komunikim e cila ka qenë e integruar kuadër të lëndës Firmë Ushtrimore, pjesërisht janë shkruar orët e mbajtura dhe disa fare nuk janë shkruar në rubrikat për shënimin e orës që duhet mbajtur.

Nga procesverbali i mbajtur gjatë inspektimit special nr.379 të dt.13.12.2015 nga MASHT – Departamenti i Inspeksionit të Arsimit – Sektori i Inspeksionit të Arsimit në Prizren, është vërtetuar se me dt.18.12.2014 është bërë inspektimi në SHME “ Y. P. “ në Prizren, ku gjatë inspektimit kanë qenë të pranishëm M. G. – drejtoreshë e shkollës dhe nga inspeksioni – R. J., M. N. dhe H. B., i cili inspeksion ka gjetur se orët e lëndës Gjuhë dhe Komunikim në paralelet XII-1 deri XII-7 nuk janë mbajtur nga data 09.09.2014 deri me datë 05.12.2014 dhe kanë rekomanduar të kompensohen të gjitha orët e përealizuara nga lënda Gjuhë dhe Komunikim në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit

të këtij procesverballi, - të merren masa ndëshkuese ndaj mësimdhënës Sh. H. për mos realizimin e planit dhe programit të lëndës Gjuhë dhe Komunikim.

Nga lista e pagave nga buxheti i R. së Kosovës për të akuzuarën Sh. H. – K. për muajt Shtator, Tetor dhe Nëntor 2014, është vërtetuar se e njëjta ka marrë pagë për punën e kryer si mësimdhënëse, gjatë periudhës kohore shtator ku ka marrë pagë në shumë prej 389.07 euro, tetor – në shumë prej 454.77 euro dhe nëntor 2014 – në shumë prej 454.77 euro.

Në bazë të gjitha provave materiale si dhe nga dëgjimi i vet të akuzuarave si dhe dëshmitë e dëshmitarëve gjykata konstatoi se në rastin konkret nuk është kontestuese se e akuzuara M. G. ka qenë gjatë periudhës kohore 2014/15 përkatësisht prej muajit Maj të vitit 2014 e deri në fund të muajit Dhjetor 2015 ka qenë në cilësi të drejtoreshës së shkollës së mesme ekonomike “ Y. P. “, Ndërsa e akuzuara Sh. mësimdhënëse e cila përveç lëndës mësimore “ Gjuhë dhe letërsi shqipe “ ka dhënë edhe lëndën mësimore “ Gjuhë dhe komunikim “ e cila lëndë ka qenë integruar brenda lëndës mësimore “ Firmë Ushtrimore “ e të cilën lëndë mësimore e ka dhënë edhe një profesoreshë tjetër, dhe këto orë kanë qenë të caktuara të mbahen për klasat e XII. Gjithashtu nuk është kontestuese se në këtë shkollë kanë qenë inspektorët e arsimit të cilët kanë bërë kontrollimin e ditarëve të shkollës me ç’rast kanë konstatuar parregullsi përkatësisht kanë konstatuar se orët e lëndës gjuhë dhe komunikim në paralelet XII-1 deri XII -7, nuk janë mbajtur dhe si rezultat i kësaj kanë përpiluar procesverbal ku edhe shkollës i kanë rekomanduar që të kompenzohen të gjitha orët e përealizuara nga kjo lëndë në afat prej 60 ditëve nga këtij procesverballi, kanë rekomanduar që të merren masa ndëshkuese adekuate ndaj mësimdhënës Sh. H. për mos realizimin e planit dhe programit të lëndës gjuhë dhe komunikim, kanë rekomanduar që Drejtoria e shkollës të përpilojë planin e mbajtjes së orëve të lëndës gjuhë dhe komunikim dhe me shkrim ta njoftojë SIA në Prizren në afat prej 8 ditëve. Nuk është kontestuese dhe në tërësi është vërtetuar se e akuzuara M. G. në cilësi të drejtoreshës së shkollës i ka zbatuar në tërësi rekomandimet të cilat i janë dhënë nga Inspektorati(SIA) në Prizren, ashtu që ka përpiluar planin për mbajtjen e orëve të realizuara nga e akuzuara Sh. të cilët orë e njëjta i ka mbajtur-kompensuar gjatë muajve janar, shkurt, mars të vitit 2015, ndaj mësimdhënës –të akuzuarës Sh. H. ka dhënë qortim gojor të shprehur me shkrim, si dhe ka njoftuar SIA në Prizren gjë që është vërtetuar nga dëshmitari R. J. inspektor pranë SIA në Prizren.

Andaj, bazuar nga kjo gjendje e çështjes, në rastin konkret, rrjedh konkluzioni se e akuzuara M. G., në cilësi të drejtoreshës së shkollës së mesme ekonomike “ Y. P. “ në Prizreni, duke zbatuar ligjin para universitar ka respektuar të gjitha obligimet që rrjedhin nga detyrat e punës të cilat i kanë takuar, edhe duke i zbatuar të gjitha rekomandimet e Inspektoratit të arsimit, në rastin konkret nuk i është shkaktuar asnjë dëm askujt, është bërë kompensimi i orëve të pa mbajtura dhe profesoresha këtu e akuzuara Sh. H. e cila ka qenë e caktuar të mbajë orët shtesë për lëndën mësimore “ Gjuhë dhe komunikim “, e njëjta i ka mbajtur dhe për këto orë shtesë nuk është paguar, çfarë do të thotë se nxënësit në rastin konkret asgjë nuk kanë humbur. Prandaj nga të gjitha të cekurat si më lartë përfundimisht është vërtetuar se në rastin konkret nuk ka përfitim pasuror për tjetrin, nuk ka dëm material të shkaktuar dhe nuk ka shkelje të të drejtave të personit tjetër, pra nuk janë plotësuar asnjë nga elementet qenësore të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarës M. G. me ç’rast edhe nuk është provuar se e njëjta ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me akuzë.

Duke pasur parasysh se për ekzistimin e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autorizimit zyrtar, për të cilën akuzohet e akuzuara duhet të ekzistojë qëllimi për të përfituar dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete ose për tjetrin, apo për ti shkaktuar dëm tjetrit dhe gjykata gjatë administrimit të të gjitha provave, dëgjimit të dëshmitarëve nuk ka mund të vërtetojë qëllimin e të akuzuarës për kryerjen e kësaj vepre penale, që e njëjta duke shfrytëzuar autorizimet e

saja, i ka tejkualuar kompetencat ose nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare për të përfituar dobi pasurore të kundërligjshme.

Së këndejmi, pas vlerësimit të provave materiale (provave të lart theksuara), dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura në tërësi, dhe të gjitha së bashku, gjykata gjeti se nuk është provuar se e akuzuara të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë për të cilën akuzohet nga ana e prokurorit të shtetit, respektivisht veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 dhe 2 nën. par. 2.1 dhe 2.2 të KPK.

Vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, përcakton: “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që ti shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër...”.

Pra, përgjegjësinë penale për këtë veprë penale një i akuzuar e ka nëse si person zyrtar e shfrytëzon detyrën apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër duke i shkaktuar dëm personit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër, e që në rastin konkret nuk është provuar një gjë e tillë.

Sa i përket të akuzuarës Sh. H. K. nga të gjitha të cekurat si më lartë respektivisht pas administrimit të gjitha provave, dëgjimit të dëshmitarëve dhe mbrojtjeve të akuzuarave, vërtetohet dhe nuk është kontestuese se e akuzuara Sh. H. – K. ka qenë e caktuar për mbajtjen e orëve të lëndës “ Gjuhë dhe Komunikim “, e cila lëndë ka qenë në kuadër të lëndës “ Firmë Ushtrimore “ e njëjta edhe pse ka qenë e obliguar të mban orët gjatë periudhës kohore shtator – dhjetor 2014 e cila një pjesë të orëve në këtë periudhë nuk e ka mbajtur si dhe nuk ka shënuar në ditar mbajtjen e orëve e që Inspektorati i Arsimit në rekomandimet e dhëna e ka cilësuar si mosrealizim i planit dhe programit për lëndën Gjuhë dhe Komunikim, mirëpo e njëjta pas rekomandimit nga ana e inspektorëve të arsimit i ka mbajtur orët shtesë duke i kompensuar orët e humbura dhe duke mos u kompensuar me pagë nga ana e buxhetit të Kosovës. E akuzuara Sh. i ka mbajtur orët plotësuese dhe nxënësit nuk kanë humb asgjë, pas që janë kompensuar orët. Po ashtu nuk qëndron pretendimi i prokurorisë se buxheti i Kosovës është dëmtuar, pasi që e akuzuara Sh. nuk ka marr dy paga për orët shtesë por ka marr rrogën për angazhimet e saja si profesoreshë në shkollën e mesme “Y. P.” pasi që në këtë shkollë ka dhënë lëndën Gjuhë dhe Letërsi.

Nga të lartcekurat gjykata sa i përket të akuzuarës Sh. H. – K., ka nxjerrë konkluzion se vepra me të cilën akuzohet nuk përbën veprë penale ngase në veprimet e saja nuk plotësohen elementet e veprës penale që i ngarkohet. Në të vërtetë veprimet e të akuzuarës Sh. H. K. të përshkruara në akuzë, pra mos mbajtja e orëve në lëndën Gjuhë dhe Komunikim që sipas Inspektoratit të Arsimit në rekomandimet e dhëna i ka cilësuar si mosrealizim i planit dhe programit për këtë lëndë, sipas gjykatës këto veprime nuk përbëjnë veprë penale, ngase realizimi apo mosrealizimi i një plani të caktuar në rastin konkret të planit dhe programit të një lënde të caktuar nuk hynë në fushën e inkriminimit penal, pra nuk ekziston kundërligjshmëria, nuk ekziston dëmi, nuk ekziston pasojja, nuk ka përfitim material për vete apo tjetrin, nuk ka shkelje të të drejtave të tjetrit kështu që nuk plotësohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet rrjedhimisht vepra me të cilën akuzohet nuk përbën veprë penale.

Andaj duke u bazuar nga të lartcekurat dhe provat të cilat u administruan nuk është provuar se e akuzuara M. G. ka kryer veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë ndërsa për të akuzuarën Sh. H. K. vepra me të cilën akuzohet nuk përbënë vepër penale, prandaj të njëjtat i liroi nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
P.nr.116/2015 më datë 05.04.2016**

**Procesmbajtësja
Birsen Kume**

**Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.